



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 28.01.2019	Numri i seancës për këtë çështje: 2 (dy)
<i>Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).</i>			
<b>A. Informacioni bazë</b>			
Institucioni dhe tema:	<i>Institucioni: Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA). Objekti: Procesi për rivlerësimin kalimtar të subjektit, z. Artan Laze.</i>		
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>z. Artan Laze</i>		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.</i>		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Seanca u shty për në datën 31.01.2019, ora 12:00. Arsyeja: Marrja e vendimit.</i>		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Në fund të seancës dëgjimore trupit gjykues u tërhoq për marrjen e vendimit dhe shtyu seancën vetëm për shpalljen e tij në datën 31.01.2019, ora 12:00.</i>		
<b>B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca</b>			
Trupa gjykuese (emrat)	<i>Kryesues: Sokol Çomo, Relatore: Albana Shtylla, Anëtarë: Ardian Hajdari, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz</i>		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	<i>Përfaqësuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit(OMN): zj.Elka Ermenkova.</i>		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>Sokol Hazizaj (Avokat)</i>		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Amilda Celami</i>		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	<i>Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u lejuan gazetarë, qytetarë të rastësishëm, përfaqësues të organizatave të shoqërive civile, familjarë të subjektit të rivlerësimit, si dhe kushdo që mund të ishte i interesuar. Numri total i të pranishmëve varionte 10-15 persona.</i>		
Media e pranishme:	<i>Të pranishëm ishin gazetarë të mediave të ndryshme por jo operatorë.</i>		
<b>C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?</b>	<i>Po/Jo</i>	<i>Nëse po, si u justifikua ai?</i>	<i>Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?</i>
<b>D. Përmbajtja e çështjes</b>	<b>Argumenti</b>	<b>kush e ka dhënë argumentin</b>	<b>A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?</b>
	Ankimi është bazuar në: - Shkelje të procedurave ligjore, -Kërkesa për përjashtimin e një anëtari të trupës gjykuese të KPK-së, dhe nëse ka ndikuar ose jo në bazueshmërinë e vendimit të dhënë nga kjo trupë.	Kryesuesi i trupit gjykues Relatori i çështjes	

	<p>z. Hazizaj fillimisht u shpreh rreth pretendimeve të dhëna gjatë seancës së kaluar për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues të KPK-së, zj. Bekteshi dhe mbi faktin që vendimi duhet të cilësohet absolutisht i pavlefshëm. Vendim duhet të priset pasi: 1.Ka shkelur të drejtat personale dhe ligjore të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ. 2. Ka cënuar frymën dhe përmbajtjen e KPrA dhe KPrC. 3. Janë shkelur normat ligjore të ligjit 84/2016. 4. Janë interpretuar në mënyrë të gabuar të gjitha provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit. Nuk është bërë analizë e tyre dhe nuk kanë konsideruar asnjë provë. 5. Kanë shkelur parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit. KPK nuk ka marrë një vendim të ndërmjetëm. Në kundërshtim me nenin 45 të ligjit 84/2016 nuk është kryer asnjë analizë provë dhe janë manipuluar tabelat financiare. KPK ka qenë e paragjykuar. Lidhur me Interesin e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt gjyqësor u cilësuan dy momente: 1. Vendosija mbi bazën e një kriteri duke cënuar kështu nenin 6 të KEDNJ dhe standardet e procesit gjyqësor. 2. shkelja e parimit të mos diskriminimit. Duhet pasur parasysh që Kushtetuta e RSH njuh rrëzimin e vendimi ndërsa ligji 84/2016 njuh prishjen e vendimit.</p>	Mbrojtja	
	<p>z. Laze citoi që vendimi i KPK-së vjen si rezultat i shkeljeve të rënda procedurale dhe është i paarsyetuar duke sjellë një vendim të pabazuar, nul. Sipas tij duhet shqyrtuar çështja në themel. Vendimi nuk përmban analizë ligjore të të gjitha pretendimeve të ngritura duke cënuar kështu nenin 6 të KEDNJ. Konkluzionet paraprake, konkluzionet përfundimtare dhe vendimi janë identike duke sjellë një vendim të paragjykuar. Sipas z. Laze procesi duhet të kryhet mbi bazën e tre kritereve, edhe pse vendimi mund të bazohet vetëm në një kriter. Nëse KPA do të jap një vendim duke marrë për bazë atë të KPK-së, çështja do të dërgohet në Gjykatën e Strasburgut. Ai citoi që: 1.KPA duhet ti marrë opinionin Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut , për të verifikuar nëse është bërë shkelje e nenit 6 të KEDNJ dhe nëse janë shkelur standardet e procesit të rregullt gjyqësor. 2. Duhet verifikuar nëse kryerja e procedurës hetimore dhe kalimi i barrës së provës, nëse janë në përputhje me nenin 6 të KEDNJ dhe parimit të mos diskriminimit. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, ILKDPKI ka bërë shkelje, nuk ka kryer asnjë hetim administrativ. Z. Laze citon të gjithë pasurinë e tij dhe mënyrën e krijimit të tyre, që sipas tij çdo gjë është transparente, nuk është bërë fshehje apo deklarim i rremë ndryshe nga çfarë ka parashikuar ILKDPKI në raportin e saj.</p>	Subjekti	
		Kryesuesi i trupit Gjykues	
	<p>Z. Como pas fjalës së subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtësit të tij ligjor komunikoi që trupi gjykues do tërhiqej për rreth 30 min. gjatë zhvillimit të seancës,, për të shqyrtuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtësit të tij ligjor. Në rikthim kryesuesi i trupit gjykues pohoi se KPA ka zhvilluar një gjykim të plotë, ka marrë në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e KPK-së dhe çdo akt e provë tjetër, ka dëgjuar konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtësit të tij ligjor. Si përfundim trupi gjykues i dha fund shqyrtimit gjyqësor dhe u tërhoq për marrjen e vendimit.</p> <p>Subjekti i rivlerësimit si fjalë të fundit kërkoi prishjen e vendimit të dhënë nga KPK dhe ri konfirmimin e tij në detyrë si gjyqtar.</p>	<p>Kryesuesi i trupit gjykues</p> <p>Subjekti</p> <p>Komisionerët Publik</p>	

<p><b>E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)</b></p>	<p>Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit z. Artan Laze, Gjyqtar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor, Tiranë zgjati rreth 2 orë, duke u paraqitur e rregullt, në respektim të një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm. Pati kontestime, pretendime verbale dhe me shkrim nga subjekti i rivlerësimit dhe mbrojtësi i tij ligjor. Ndër pretendimet e paraqitura mund të përmendim: Vendimi i KPK-së duhet të rrëzohet pasi: 1.Ka shkelur të drejtat personale dhe ligjore të subjektit të rivlerësimit në përputhje me nenin 6 të KEDNJ. 2.Ka cënuar frymën dhe përmbajtjen e KPrA dhe KPrC. 3. Janë shkelur normat ligjore të ligjit 84/2016. 4. Janë interpretuar në mënyrë të gabuar të gjitha provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit. Nuk është bërë analizë e provave dhe nuk është konsideruar asnjë provë. 5. Shkelja e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Ndër pretendimet e z. Laze ishin që KPA duhet të marrë opinion nga Gjykata Europiane të të Drejtave të Njeriut, për të verifikuar nëse është bërë shkelje e nenit 6 të KEDNJ dhe nëse janë shkelur standardet e procesit të rregullt ligjor. Trupi gjykues në asnjë moment nuk shkelti rregullat e etikës, profesionalizmit dhe nuk u vërejtën probleme të kësaj natyre. Subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të paraqitej me mbrojtës ligjor z. Sokol Hazizaj. Përmasat e sallës ku u zhvillua seanca dëgjimore, ishin të mjaftueshme për të paraqitur të gjithë të pranishmit që nuk ishin të shumtë në numër. Trupi gjykues u tërhoq duke caktuar datën 31.01.2019 ora 12:00 për shpalljen e vendimit.</p>
---	---